

D E K R E T
Nr.1502, datë 31.5.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7678, DATË 3.3.1993 "PËR AKCIZAT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në nenin 3 të ligjit nr.7678, datë 3.3.1993, ndryshuar me ligjin nr.8083, datë 7.3.1996, bëhen këto ndryshime:

- Pika "dh" shfuqizohet.
- Në paragrafin e parafundit, fjalët "... për energjinë elektrike 50 për qind, përjashtuar disa përdorues të sektorëve kryesorë të ekonomisë dhe ...", shfuqizohen.

Neni 2

Ligji nr.8057, datë 8.2.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7678, datë 3.3.1993 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.7797, datë 23.2.1994, ligjin nr.7821, datë 11.5.1994 dhe ligjin nr.7901, datë 15.2.1993, shfuqizohet.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë".

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha